



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 18.03.2013
Nr.0204 - 295

PËR: Blerim Kuçi, Kryetar i Komunës së Suharekës
Veseli Maliqaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SUHAREKËS,
01- Nr -16- 1685, Pranuar me datë: 08.03.2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01- Nr- 16 -1685, të miratuar me datë 28.02.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili ka efekt të plotë juridik:

- Vendimi 01- Nr - 16 - 1685 për Formimin e Komisionit për të dalur në teren për ta Konstatuar Gjendjen Faktike në Qendren Zejtare Nr.-2 në Suharekë.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Drejtorëve të Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 18.03.2013
br.0204 - 295

Za: Blerim Kuçi, Gradonačelnik opštine Suva Reka
Vesel Maliqaj, Predesedavajući Skupštine opštine Suva Reka

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Suva Reka, 01, Primljeno dana : 08.03.2013
01 Nr. - 16 - 1685

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-040, dodatak XII uredbе Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke 01- br- 16 -1685, odobreno dana 28.02.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka 01- br - 16 - 1685 o formiranju komisije za potvrdu činjeničnog stanja zanatskog centra br.-2 u Suvoj Reci.

Sa poštovanjem,

pc
Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), neneve 15, 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2013, mori këtë:

V E N D I M
Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për të dalur në teren për ta konstatuar gjendjen faktike në qendrën zejtare Nr-2 në Suharekë në këtë përbërje .

1. Avdyl Sopa-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
2. Shaban Gallapeni-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
3. Xhelal Çelaj-----përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
4. Halit Berisha -----përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
5. Gezim Gega-----përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e komisionit janë që të dalin në teren për të caktuar kufit administrativ (pikat) e qendrës zejtare Nr-2 në Suharekë, të hartojnë projekt vendimin që të ndalohet ushtrimi i veprimtarive të lokaleve afariste që ushtrojnë veprimtarin, kafitërit, diskotekat, klubet e natës, lojërat e fatit, bastorët sportive, dhe lokaleve tjera që shërbejnë pije alkoolike në qendrën zejtare Nr-2, në Suharekë dhe ti rekomandojnë Kuvendit të Komunës për procedurat e mëtutjeshme.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, mbi vetëqeverisjen lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), nenit 18, të Rregullores, Nr-01/2013, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-16-1685
Me datë 06.03.2013



Kryesuesi i Kuvendit

V. Maliqaj
Vesel Maliqaj